

RELACION

PËR

PROJEKTIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “HEKURUDHAT SHQIPTARE - REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE TIRANË - DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.29/2017”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, ratifikuar me ligjin nr.29/2017”.

Ndryshimi konsiston në shtimin e vlerës së huas, të akorduar fillimisht nga BERZH-i nga 36 870 000 në 77 570 000 euro. Pra, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ndryshuese do të akordohet një financim shtesë prej 40 700 000 eurosh për projektin në fjalë. Kjo shtesë financimi do të ketë ndikim të konsiderueshëm në implementimin e projektit në tërësi, si edhe në vijueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij gjatë procesit të shfrytëzimit të kësaj linjeje hekurudhore.

Projekti i rehabilitimit të linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës ka për qëllim ndërtimin e një linje të re për në Aeroportin e Tiranës edhe modernizimin e linjës ekzistuese Tiranë - Durrës, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës hekurudhore, në përputhje me standardet e BE-së të një rrjeti TEN-T, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe sigurisë së transportit hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve përgjatë këtij segmenti hekurudhor.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është planifikuar në programin analitik të akteve, për vitin 2024.

Projekti është pjesë e listës unike të projekteve me rëndësi kombëtare (NSPP), miratuar me vendimin nr.161, datë 20.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2025-2027”.

Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2030, ku një ndër qëllimet strategjike është edhe zbatimi i investimeve që lidhen me përmirësimin e aksesit në pikat hyrëse-dalëse tokësore, përmirësimin e korridoreve rrugore, ndërtimin e porteve, ndërtimin e aeroporteve, ndërtimin e hekurudhave, stacioneve multimodale etj.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projekti i rehabilitimit të Hekurudhës Shqiptare bashkëfinancohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, me një hua në vlerën 36 870 000 euro, e akorduar nëpërmjet marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, ratifikuar me ligjin nr.29/2017”.

Ky projekt bashkëfinancohet edhe nëpërmjet fondeve grant të akorduara nga donatorët, nëpërmjet:

1. marrëveshjes së grantit të investimit WBIF, në vlerën 35 435 000 euro, ratifikuar me ligjin nr.52/2018;
2. marrëveshjes së grantit të BERZH-it për projektin e detajuar të linjës hekurudhore Durrës - Tiranë dhe vlerësimin financiar /ekonomik të të gjithë rrjetit hekurudhor në Shqipëri, në vlerën 1 103 000 euro, ratifikuar me ligjin nr.63/2015, datë 11.6.2015.

Këto financime janë dhënë me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe standardeve institucionale, administrative dhe ato të ruajtjes së mjedisit të Hekurudhës Shqiptare, në përputhje të plotë me standardet e BERZH-it dhe direktivave të BE-së, me impakt të konsiderueshëm në implementimin e projektit, si dhe në vijueshmërinë e qëndrueshmërinë e tij gjatë procesit të shfrytëzimit të kësaj linje hekurudhore. Gjithashtu, nëpërmjet këtij projekti hekurudhor promovohet transporti i gjelbër dhe i qëndrueshëm dhe nxitet kalimi nga transporti rrugor në transportin hekurudhor, duke promovuar një alternativë më eficiente për komunitetin dhe bizneset.

Shtesa e huas, që parashikohet në këtë marrëveshje ndryshuese, do të shërbejë për ndërtimin e një elementi shumë të rëndësishëm dhe plotësues të projektit në tërësi,

i cili nuk ka qenë parashikuar në projektin fillestar. Ky element përfshin ndërtimin e tetë godinave të stacioneve hekurudhore dhe sistemit të shesheve të jashtme përgjatë linjës ekzistuese Durrës-Tiranë dhe të linjës së re që do të ndërtohet për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, sipas të gjitha standardeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, do të financojë edhe shtesën e kostos së projektit ardhur, si pasojë e indeksimit të çmimeve të materialeve ndërtimore.

Objektivi kryesor, që do të realizohet nëpërmjet shtesës së financimit prej 40.7 milionë eurosh, që akordohet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje ndryshuese, është financimi i ndërtimit të godinave të stacioneve dhe shesheve të jashtme, me vlerë rreth 10.5 milionë euro, financimi i shtesës së kontratës së punimeve, si pasojë e indeksimit të çmimeve të materialeve të ndërtimit, me vlerë rreth 29 milionë euro, si dhe financimi shtesë i kontratës së mbikëqyrësit të punimeve, me vlerë 1.2 milionë euro, si pasojë e zgjatjes në afat të kontratës ekzistuese dhe shtesës së kontratës së re për ndërtimin e godinave të stacioneve, të detajuara, si më poshtë vijon:

- Ndërtimi i godinave të stacioneve dhe shesheve të jashtme përgjatë linjës hekurudhore ekzistuese Durrës-Tiranë dhe linjës së re hekurudhore, që do të ndërtohet në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës (TIA), si një kontratë e re shtesë në kuadër të projektit të hekurudhës;
- Financimi i shtesës së vlerave të materialeve ndërtimore, të përdorura gjatë implementimit të projektit, si pasojë e indeksimit të çmimeve;
- Shtesa e vlerës së kontratës së mbikëqyrjes, e cila do të përfshijë zgjatjen e kontratës ekzistuese të punimeve ndërtimore, si dhe kontratën e re për ndërtimin e godinave të stacioneve;
- Afati i zbatimit të projektit është data 31 gusht 2025.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, dhe nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr.548, datë 4.9.2024, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar ndërmjet palëve. Në zbatim të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 121, të Kushtetutës, kjo marrëveshje ndryshuese do të hyjë në fuqi pas ratifikimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektligj nuk përafron me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare - rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, ratifikuar me ligjin nr.29/2017”.

Ndryshimi konsiston në shtimin e vlerës së huas, të akorduar fillimisht nga BERZH-i, nga 36 870 000 në 77 570 000 euro.

VII. MINISTRITË, PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Hekurudha Shqiptare, sh.a., në cilësinë e entit zbatues të projektit.

VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji i propozuar është hartuar nga Ministria e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Financimi i këtij projekti është parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm, 2024-2026 dhe më konkretisht në programin “Transporti hekurudhor” të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Huaja shtesë, që do të akordohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në shumën 40.7 milionë euro, ka termat financiarë të huas bazë, ratifikuar me ligjin nr.29/2017.

KËSHILLI I MINISTRAVE